

Muhamed Ibën Abdul Uehab

# Tri parimet e Besimit Islam

■ Fetvaja e Komisionit  
të përhershëm të fetvave  
mbi propagandën  
për unifikimin e feve

Titulli i librit: ***Tri Parimet e Besimit Islam***

■ ***Fetvaja e Komisionit të  
përhershëm të fetvave mbi  
propagandën për unifikimin e feve***

Autor: ***Muhamed Ibën Abdul Uehab***

Përkthyes: ***Azem Bardhoshi***

Faqësja dhe Kopertina: ***Ilmi Shahu***

Shtypur në shtypshkronjën: ***“MILENIUM I RI”***

Adresa: ***Autostradë Tiranë - Durrës, km 26***

Mobile: ***+355 672063702***

E-mail: ***info@mileniumiri.de***

Http://***www.mileniumiri.de***

**BISMIL LAHIRR RRAHMANIRR  
RRAHIM**

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëbërësit!*

Dije, Allahu të mëshiroftë, se është detyrë për ne të dimë katër gjëra:

1. Dija, e cila është njohja e Allahut, e të Dërguarit të Tij dhe e fesë Islame me argumente.
2. Të punuarit sipas kësaj dije.
3. Thirrja në këtë dituri.
4. Durimi ndaj vështirësive në këtë thirrje.

Argument për këtë është fjala e Allahut:  
**“(Betohem) për kohën. Me të vërtetë njeriu është në humbje të sigurt, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë**

**vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durim”.** (El-Asr 1-3).

Imam Shafiu ka thënë: “Sikur Allahu të mos zbriste tek krijesat e Tij argument tjetër përveç kësaj sureje, ajo do t’u mjaftonte atyre”. Ndërsa Buhariu ka thënë: “Dituria është para fjalës dhe punës”. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Dije se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.”** (Muhamed, 19).

Pra Allahu ka filluar me diturinë para fjalës dhe punës.

Mëso, Allahu të mëshiroftë se është detyrë për çdo musliman e muslimane mësimi i tri çështjeve të mëposhtme dhe të punuarit me to:

E para: Allahu na ka krijuar, na ka furnizuar dhe nuk na ka lënë pas dore, por ka dërguar te ne një të dërguar, kush i bindet, do

të futet në Xhenet dhe kush e kundërshton do të futet në Zjarr. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Ne, me të vërtet, ju kemi sjellë një të dërguar (Muhamedin) dëshmitarë mbi ju, ashtu siç ia çuam një të dërguar (Musain) Faraonit, por Faraoni nuk iu bind të dërguarit (Musait) kështu që Ne e mbërthyem atë me ndëshkim të ashpër...”**. (Muzemil, 15-16)

E dyta: Allahu nuk pranon që të shoqërohet askush me të në adhurim, qoftë melek i afërt apo profet i dërguar. Argument për këtë është thënia e Allahut: **“Xhamitë janë për adhurimin e Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!”** (Xhin, 18).

E treta: Kush i bindet të Dërguarit të Allahut dhe njëson Allahun, nuk i lejohet të miqësohet me ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe

nëse këta njerëz mund të jenë nga më të afërmit e tij.<sup>(1)</sup> Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të kenë dashuri ndaj atyre, që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe nëse ata janë baballarët e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besim në zemrat e tyre dhe i ka forcuar me ndihmën e Vet. Ai do t’i dërgojë ata në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do**

---

<sup>(1)</sup> Pohimi i sipërcituar dhe ajeti duhet të kuptohet në përputhje me thënien e Allahut: “Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (Mumtehine 8). Ne nuk i quajmë vëllezër në fe ata të cilët nuk e besojnë Zotin ashtu siç besojmë ne dhe që nuk janë muslimanë, por nga ana tjetër, ne bashkëjetojmë me ta, nuk u cenojmë jetën dhe pasurinë dhe sillemi në mënyrë njerëzore me ta, pa u bërë asnjë të keqe, madje u bëjmë dhe mirësi kur kemi mundësi.

**të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Allahun. Ata janë pala e Allahut dhe, vërtet që pala e Allahut janë të shpëtuarit.”** (Muxhadele, 22).

Mëso, Allahu të drejtoftë në bindjen e Tij, se hanefijeh (feja e pastër), rruga e Ibrahimit, është të adhurosh Allahun Një të Vetëm me sinqeritet. Pikërisht për këtë Allahu i ka urdhëruar të gjithë njerëzit dhe për këtë arsye i ka krijuar. Allahu thotë: **“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.”** (Dharijat, 56).

Kuptimi i fjalës “adhurojnë” është “njësojnë”.

Çështja më e madhe dhe më e rëndësishme për të cilën ka urdhëruar Allahu është teuhidi. Ai është njësimi i Allahut në adhurim.

Çështja më e madhe dhe më e rëndësishme të cilën Allahu e ka ndaluar është idhujtaria

(shirku), ajo është lutje e drejtuar tjetërkujt bashkë me Allahun. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë ...”**. (En-Nisa, 36)

Nëse pyetesh se cilat janë tri parimet që një person duhet t'i njohë? Thuaj: njeriu duhet të njohë Zotin e tij, fenë e tij dhe të dërguarit e tij Muhamedin (salAll-llahu alejhi ue selem).

### ***Parimi i parë:***

Nëse të thuhet: Kush është Zoti yt? Thuaj: Zoti im është Allahu, i Cili me mirësitë e Tij kujdeset për mua dhe të gjitha botët (gjithësinë). Ai është i Adhuruari im, nuk kam të adhuruar tjetër përveç Tij. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve”**. (El-Fatiha, 1).



Çdo gjë tjetër përveç Allahut është botë (krijesë). Edhe unë jam një prej krijesave.

Kështu nëse të thuhet: Mbi ç'bazë e njohë Zotin tënd? Atëherë thuaj: E kam njohur me anë të shenjave dhe krijesave të Tij. Nga shenjat e Tij janë: nata dhe dita, dielli dhe hëna, ndërsa nga krijesat e Tij janë: shtatë qiejt, shtatë tokat dhe çdo gjë që është në to e midis tyre. Argumentim për këtë është fjala e Allahut: **“Nga shenjat e Tij janë nata dhe dita, dielli dhe hëna; mos i bëni sexhde, as diellit dhe as hënës, bëjini sexhde vetëm Allahut që i ka krijuar ato.”** (Fusilet, 37). Po ashtu fjala e Allahut: **“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë e pastaj u lartësua mbi Arsh. Ai me natën mbulon ditën që ndjek me të shpejtë mbulimin e dritës. Dielli, hëna dhe yjet janë nën sundimin e Tij. Vërtet Atij i përket krijimi, rregullimi**

**i punëve të krijesave, urdhërimi dhe ligjënia. I Madhëruar qoftë Allahu, Zoti i botëve!”** (Arafë, 54). Zot është i Adhuruari. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar. I Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin e ka ndërtuar me përsosmëri, i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si furnizim për ju. Prandaj mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!”** (Bekare, 22-23).

Ibnu Kethiri (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Krijuesi i këtyre gjërave është Ai që meriton të adhurohet”.

Llojet e adhurimit që ka urdhëruar Allahu si: Islami (dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut), imani (besimi i vërtetë i cili përfshin besimin e drejtë në zemër, pohimin e besimit

me gjuhë dhe veprimin sipas mësimëve të Islamit), ihsani (përsosja e adhurimit), lutja, frika, varja e shpresës për të arritur atë që dëshiron, mbështetja, dëshira për arritjen e shpërblimit të Zotit, tmerri prej dënimit të Zotit, përujta (devocioni ndaj Zotit), droja, kthimi me pendim, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, kërkimi i shpëtimit, kurhani, zotimi, të gjitha këto dhe të tjera adhurime që Allahu ka urdhëruar, duhen bërë vetëm për Allahun e Madhërueshëm. Argument për këtë është thënia e Allahut: **“Xhamitë janë për adhurimin e Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!”** (Xhin, 18).

Ai që drejton ndonjë nga adhurimet dikujt tjetër veç Allahut, është mushrik, mohues (kafir). Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar: **“Ai që krahas Allahut lut zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë prove për këtë, me siguri do**

**të japë llogaria vetëm te Zoti i tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mohuesit.”**  
(Mu'minun, 117).

Në një hadith transmetohet: “Duaja është palca e adhurimit”.<sup>(2)</sup> Argument është fjala e Allahut: “Zoti juaj ka thënë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem. Me të vërtetë, ata që nga mendjemadhësia nuk duan të më adhurojnë Mua, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.” (Gafir, 60).

Argumenti që vërteton se frika është adhurim është fjala e Allahut: **“Ju mos kini frikë prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje, nëse jeni besimtarë.”**  
(Ali Imran, 175).

Argumenti që vërteton se varja e shpresës për të arritur atë që dëshiron është adhurim është fjala e Allahut: **“... kushdo që shpreson takimin me Zotin e vet,**

---

<sup>(2)</sup> Hadithi është i dobët, por kuptimin e ka të saktë.

**le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë asnjë në adhurim Zotit të vet.”** (Kehf, 110).

Argumenti që vërteton se mbështetja te Allahu është adhurim është fjala e Allahut: **“Vetëm tek Allahu mbështetuni, nëse jeni besimtarë.”** (Maide, 23). Gjithashtu Allahu (subhanehu ue teala) thotë: **“... dhe kujtdo që mbështetet tek Allahu, Ai do t'i mjaftojë ...”** (Talak, 3).

Argumenti që vërteton se dëshira për arritjen e shpërblimit të Zotit, tmerri (nga dënimi i Zotit) dhe përuļja (devocioni) janë adhurime është fjala e Allahut: **“Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe na luteshin, me dëshirë dhe frikë. Ata ishin të përuļur dhe respektues ndaj Nesh.”** (El-Enbija, 90).

Argument i drojës është fjala e Allahut: **“Prandaj, mos u keni dronë atyre, por më keni dronë vetëm Mua.”** (El-Bekare, 150).

Argument i kthimit me pendim është fjala e Allahut: **“Kthehuni te Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij ...”** (Ez-zumer, 54).

Argument për kërkimin e ndihmës është fjala e Allahut: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ty ndihmë kërkojmë.”** (El-Fatiha, 5).

Në një hadith thuhet: “Nëse kërkon ndihmë, kërkoje prej Allahut.”

Argument për kërkimin e mbrojtjes është fjala e Allahut: **“Thuaj: Kërkoj mbrojtje te Zoti i agimit.”** (El-Felek, 1). **“Thuaj: Kërkoj mbrojtje te Zoti i njerëzve.”** (En-Nas, 1).

Argument për kërkimin e shpëtimit është:  
**“Kur kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj ...”** (El-Enfal, 9).

Argument i therjes së kurbanit është fjala e Allahut: **“Thuaj (O Muhamed): “Në të vërtetë namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak ...”**” (En’am, 161-162). Ndërsa argument nga Suneti është hadithi: “... Allahu e mallkon atë që ther kurban jo për Allahun.” Muslimi.

Argumentim i zotimit është fjala e Allahut: **“Ata i zbatojnë zotimet e tyre dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit) tmerri i së cilës është përhapur gjithkund”.** (El-Insan, 7).

### ***Parimi i dytë:***

Njohja e fesë Islame me argumentet e saj.

Islami është dorëzimi ndaj Allahut me teuhid (duke besuar se Ai është një dhe duke e adhuruar Atë të vetëm), nënshtrimi ndaj Tij me bindje dhe largimi nga idhujtaria dhe idhujtarët.

Ai është tre rangje: Islami (dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut), imani (besimi i vërtetë i cili përfshin besimin e drejtë në zemër, pohimin e besimit me gjuhë dhe veprimin sipas mësimëve të Islamit), ihsani (përsosja e adhurimit). Për çdo rang ka shtylla.

Shtyllat e Islamit janë pesë: Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij; falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i muajit të Ramazanit dhe kryerja e haxhit në shtëpinë e shenjtë të Allahut në Mekë.



Argument i dëshmisë është fjala e Allahut: **“Allahu dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij, edhe engjëjt e dijetarët e dëshmuan. Ai e mban Krijimin e Tij në drejtësi të plot. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, të Gjithëfuqishmit, më të Urtit Gjithëgjykues”**. (Ali Imran, 18).

Kuptimi i kësaj është se nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut, fjala: **“La-ilahe** (nuk ka të adhuruar)” është për të mohuar gjithçka që adhurohet përveç Allahut, ndërsa fjala: **“il-lall-llah** (përveç Allahut)” është pohimi se adhurimi i takon vetëm Allahut, i Cili nuk ka shokë në adhurim, ashtu siç nuk ka shokë në sundim. Komentin e saj (fjalës “La-ilahe il-lall-llah”) e qartëson thënia e Allahut të Madhëruar: **“(Kujto) kur Ibrahim i tha babait dhe popullit të tij: ‘Me të vërtetë që unë jam i distancuar dhe s’kam të bëj fare**

**me ato që adhuron ju, përveç Atij që më krijoi mua dhe padyshim që Ai do të më udhëzojë.’ Ai e la të përjetshme atë fjalë ndër pasardhësit e vet, me qëllim që ata të ktheheshin në bindjen e Allahut dhe adhurimin e Tij pa i shoqëruar”. (Ez-Zukhruf, 26-28).**

**“Thuaj (o Muhamed): ‘O ithtarë të Librit ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush, se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë dhe se nuk do të konsiderojmë njëri-tjetrin si zotër në vend të Allahut.’ Nëse ata nuk e pranojnë, atëherë ju thoni: Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut”. (Al-Imran, 64).**

Argument se Muhamedi është i dërguari i Allahut është thënia e Allahut: **“Tashmë juka ardhur një i dërguar (Muhamedi) nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet**

**tuaja, dëshiron (lakmon) besimin tuaj dhe përmirësimin e gjendjes suaj dhe është i butë (i ndjeshëm, zemërdhembshur) e i mëshirshëm për besimtarët.”** (Teube, 128).

Domethënia e dëshmisë se Muhamedi (salAll-llahu alejhi ue selem) është i dërguari i Allahut është: bindja në gjithçka që ka urdhëruar, besimi në gjithçka që ai na ka lajmëruar, largim nga gjërat që na ka ndaluar, si dhe të adhurosh Allahu sipas mënyrës që ka ligjëruar.

Argumenti i namazit, zekatit dhe komentit të teuhidit (njësimit të Allahut) është thënia e Allahut të Madhërueshëm: **“Ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun, duke synuar me adhurim vetëm Atë, duke qenë të shmangur nga idhujtaria, si dhe të falin namazin e të japin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”** (El-Bejineh, 5).

Argumenti i agjërimit është thënia e Allahut: **“O ju që besuat, agjërimi është bërë detyrë për ju, ashtu siç ishte detyrë edhe për ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të devotshëm.”** (El-Bekareh, 183)

Argumenti i haxhit është thënia e Allahut: **“...vizita e shtëpisë (Kabës) është detyrë për atë që ka mundësi ta përballoj udhëtimin te ajo. E kush nuk beson (mohon haxhin si shtyllë të Islamit), atëherë Allahu nuk ka nevojë për askënd.”** (Al-Imran, 98).

Rangu i dytë i fesë është Imani. Imani është 70 e ca degë, më e larta është fjala LA ILAHE IL-LALL-LLAH, kurse më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga, turpi është pjesë e imanit.

Shtyllat e imanit (besimit) janë gjashtë: besimi në Allahun, në melaiket, në Librat e

Tij, në të dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit dhe në kader (paracaktimin e gjithçkaje) i mirë apo i keq (qoftë ky).

Argumenti për gjashtë shtyllat e imanit është fjala e Allahut të Lartësuar: **“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, melekët, në Librin dhe të dërguarit ...”** (Bekare, 177).

Ndërsa argument për kaderin (paracaktimit) është ajeti: **“Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.”** (Kamer, 49).

Rangu i tretë është ihsani (përsosja e adhurimit). Ai ka vetëm një shtyllë, ajo është: të adhurosh Allahun sikur ti e shikon Atë. E nëse nuk arrin ta adhurosh sikur e shikon Atë, atëherë adhuroje me ndjenjën se Ai të shikon ty.

Argument është fjala e Allahut: **“Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë muhsinunë (punëmirë).”** (Nahl, 128). **“Dhe mbështetu tek i Plotfuqishmi, Mëshirëploti, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulen në sexhde. Vërtet, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”** (Shuara, 217-220). **“Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju e kryeni atë. Zotit tënd nuk i fshihet as një grimë peshe, në Tokë a në qiell; as më e vogël se ajo dhe as më e madhe, nuk mbetet pa u shënuar në Librin e Qartë.”** (Junus, 61).

Argument nga Suneti është hadithi i njohur i Xhibrilit, i transmetuar nga Umer bin Hatabi r.a., i cili thotë: “Një ditë ishim

duke ndenjtur me të Dërguarin e Allahut a.s. kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Nuk linte përshtypjen se është ndonjë udhëtar dhe asnjë prej nesh nuk e njihte. Ai u ul pranë të Dërguarit a.s. duke i mbështetur gjunjët e vet në gjunjët e pejgamberit, duart e veta i vendosi në kofshën e tij dhe i tha: “O Muhamed! Më trego ç’është Islami?” I Dërguari a.s. i tha: “Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zukatin, të agjërosh ramazanin, të kryesh haxhin në Kabë, në qoftë se ke mundësi për këtë.” Ai iu përgjigj: “Të vërtetën the.” Ne u çuditëm, e pyeste dhe i thoshte të vërtetën the. Pastaj e pyeti: “Më trego ç’është imani (besimi)?” Pejgamberi a.s. tha: “Të besosh Zotin, melekët e Tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Gjykimit dhe të besosh në kader

(paracaktimin e gjithçkaje) i mirë apo i keq (qoftë ky).” Pastaj e pyeti: “Më trego ç’është ihsani (përsosja e adhurimit)?” Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Ihsani është të adhurosh Allahun sikur ti e shikon Atë. E nëse nuk arrin ta adhurosh sikur e shikon Atë, atëherë adhuroje me ndjenjën se Ai të shikon ty.” Ai e pyeti përsëri Pejgamberin: “Më trego për çastin e fundit (Kijametin)?” Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Për këtë i pyeturi nuk di më shumë se ai që pyet.” Atëherë ai e pyeti përsëri: “Më trego mbi shenjat e tij?” Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Kur robëresha të lindë zonjën e vet, kur të shihen barinj të këmbëzbathur, të zhveshur, të varfër, barinj delesh të garojnë në ndërtesa të larta.” Pastaj ai u largua, ndërsa ne qëndruam pak, i Dërguari i Allahut a.s. më tha: “O Umer! A e njeh atë që më pyeti?” Unë thashë: “Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri.” Pejgamberi u përgjigj: “Ky qe Xhebraili. Erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.” (Muslimi).



### ***Parimi i tretë:***

Njohja e të Dërguarit tuaj Muhamedit (salAll-llahu alejhi ue selem). Ai është Muhamedi, i biri i Abdullahut, i biri i Abdul Mutalibit, i biri i Hashimit, Hashi ishte prej fisit kurejsh, kurejshët janë fis arab. Arabët janë pasardhës të Ismailit të birit të Ibrahimit “el khalil” (mik i Allahut), alejhi ue ala nebijina afdalu’s-salati ue selam. Jetoj 63 vjeç, 40 vjet i kaloi para shpalljes, ndërsa 23 i ka kaluar si nebij dhe rresul. Është bërë nebij me fjalën “lexo” dhe është bërë resul me “o ti, i mbështjellë”. Vendi i tij ishte Meka. Emigroi për në Medine. Allahu e dërgoi për të tërhequr vërejtje nga shirku (idhujtaria) dhe të ftoj në teuhid (njësimin e Allahut). Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar: **“O ti, i mbështjellë (Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, rrobat e tua pastroji dhe largohu nga**

**ndyrësia (adhurimi i idhujve). Mos jep gjë, me synimin për të marrë më shumë dhe për hir të Zotit tënd, duro!”** (El-Mudethir, 1-7).

Domethënia e fjalës “çohu dhe paralajmëro” është paralajmëro nga shirku dhe fto në teuhid. **“Zotin tënd madhëroje”** do të thotë madhëroje atë me teuhid. **“Rrobat e tua pastroji”** do të thotë pastroji punët tua nga shirku. **“dhe largohu nga ndyrësia** (adhurimi i idhujve)”; er-ruxhz (ndyrësia) janë idhujt, kurse, largimi nga ata është lënia e tyre, distancimi prej tyre dhe ithtarëve të tyre. Kjo i ka marrë të dërguarit të Allahut 10 vjet, duke ftuar njerëzit në teuhid. Pas 10 vjetësh u ngjit në qiell (miraxh) dhe u obligua për faljen e pesë kohëve të namazit. Në Mekë u fal tre vjet. Pas kësaj u urdhërua për emigrim në Medine.

Hixhreti është kalim nga vendi i shirkut për në vendin e Islamit. Emigrimi është detyrë

mbi këtë umet. Ai do të vazhdoi derisa të bëhet Kijameti. Argument është fjala e Allahut: **“Kur melaiket ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me faje, thonë: “Ku ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në Tokë.” Melekët do t’u thonë: “A nuk ishte toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?” Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; sa vend i keq është ai! Me përjashtim të burrave të pa fuqishëm, gra dhe fëmijë, të cilët nuk kanë mundësi të gjenin ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugë, mbase Allahu do t’i falë, se Allahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve.”** (Nisa, 97-99).

**“O robërit e Mi, që keni besuar! Toka Ime është vërtete gjerë, andaj më adhuronit vetëm Mua!”** (El-Ankebut, 56).

Begaviu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Shkakut i zbritjes së këtij ajet ishin muslimanët në Mekë që lanë hixhretin, Allahu i ka thirrur me emrin e besimit.”

Ndërsa argument nga Suneti për hixhretin është fjala e të dërguarit (salAll-llahu alejhi ue selem): “Nuk ka për t’u ndërprerë hixhreti derisa të ndërpritet tobja dhe nuk ka për t’u ndërprerë tobja, derisa të lindë dielli nga perëndon.”

Pasi u vendos në Medine i dërguari i Allahut (salAll-llahu alejhi ue selem) u urdhërua për detyrat e tjera të Islamit si: zekati, agjërimi, haxhi, ezani, xhahadi, urdhërimi për të mirën ndalimi nga e keqja e të tjera nga detyra islame. Kjo i mori 10 vjet, pas kësaj vdiq, lavdërimi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Por feja e tij qëndroi. E mira që na ka treguar është teuhidi dhe gjithçka që do dhe është i kënaqur Allahu, ndërsa e keqja prej të cilës ka paralajmëruar, është shirku dhe gjithçka që e urren dhe e refuzon Allahu. Allahu e dërgoi tek

të gjithë njerëzit. Allahu e bëri detyrë bindjen ndaj tij për njerëzit dhe xhinët. Argument është fjala e Allahut: **“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i dërguar i Allahut për të gjithë ju ...”** (El-Araf, 158).

Allahu plotësoi me të fenë. Argument është fjala e Allahut: **“... Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj ...”** (El-Maideh, 3).

Argument për vdekjen e tij është fjala e Allahut: **“Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!”** (Ez-Zumer, 30-31).

Njerëzit pasi të vdesin do të ringjallen. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Ne ju kemi krijuar prej Tokës, aty do t’ju kthejmë dhe prej saj do t’ju**

**nxjerrim edhe një herë tjetër.”** (Ta Ha, 55). **“Allahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t’ju nxjerrë.”** (Nuh, 17-18).

Pas ringjalljes do të llogariteni dhe do të shpërbleheni për punët tuaja. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“... për t’i shpërblyer ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t’i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.”** (En-Nexhm, 31).

Ai që përgënjeshton ringjalljen ka bërë kufër. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Ata që nuk besuan, mendojnë se nuk do të ringjallen kurrsesi. Thuaju: “Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjallen e pastaj do të njoftoheni për atë ç’keni bërë! Dhe kjo është e lehtë për Allahun.”** (Tegabun, 7).

Allahu i Lartësuar të gjithë të dërguarit i ka dërguar përgëzues dhe paralajmërues. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Të Dërguar që kanë qenë përgëzues dhe paralajmërues në mënyrë që njerëzimi të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve...”** (En-Nisa, 165). I pari i tyre ka qenë Nuhu (alejhi selam) dhe i fundit Muhamedi (salAll-llahu alejhi ue selem). Argument që i pari i tyre ishte Nuhu (alejhi salam) është fjala e Allahut: **“Ne të frymëzuam ty (o Muhamed) me shpallje, ashtu siç frymëzuam me shpallje Nuhin dhe profetët pas tij ...”** (En-Nisa, 163).

Allahui Lartësuar tek çdo popull ka dërguar të dërguar, nga Nuhu deri tek Muhamedi i ka urdhëruar ata për të adhuruar vetëm Allahun dhe i ka ndaluar ata nga adhurimi i tagutëve. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Çdo populli Ne i kemi çuar një**

**të dërguar (që u thoshte): Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni nga taguti (idhujt)!” (Nahl, 36).**

Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrë mbi të gjithë robërit mohimin e tagutit dhe besimin në Allah. Ibnu Kajjim, Allahu e mëshiroftë ka thënë: Tagut është: “Çdo gjë ndaj të cilës njeriu i tejkalon kufijtë, duke e pasuar, adhuruar ose duke iu bindur.”

Tagutët janë të shumtë, më kryesorët e tyre janë pesë:

1. Iblisi (shejtani) mbi të qoftë mallkimi i Allahut;
2. Ai që adhurohet dhe është i kënaqur me adhurimin që i bëhet;
3. Ai që i fton njerëzit në adhurimin e tij;
4. Ai që pretendon se di të fshehtë;
5. Ai që nuk gjykon me ligjin që ka zbritur Allahu.



Argument për këtë është fjala e Allahut: **“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra. Ai që mohon tagutin (idhujt dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu është Gjithëdëgjuesi i Gjithëdituri”**. (Bekare, 256). Kjo është domethënia e fjalës LA ILAHE IL-LALL-LLAH. Ndërsa në hadith përcillet: “Kreu i çështjeve është Islami, shtylla e tij është namazi dhe kulmi i çështjeve është xihadi në rrugën e Allahut.” Allahu është më i Dituri! Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi profetin tonë, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

## **FETVAJA E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË FETVAVE MBI PROPAGANDËN PËR UNIFIKIMIN E FEVE**

**Propaganda për njësimin e feve dhe përafrimin ndërmjet tyre është dalje nga Islami.**

Komisioni i përherëshëm i kërkimeve shkencore dhe fetvave

Kryetar: AbdulAziz ibn Abdullah ibn Bazi.

Zv/kryetar: AbdulAziz ibn Abdullah ibn Muhamed al-Shejh

Anëtar: Bekër ibn Abdullah ebu Zejd;  
Salih ibn Feuzan el Feuzani.

2004

Kohët e fundit po flitet shumë në konferenca, takime dhe simpoziume rreth një çështjeje e cila emërtohet njësimi i feve dhe përafrim ndërmjet tyre”. Meqenëse kjo propagandë bie në kundërshtim me parimet dhe mësimet e fesë Islame, Komisioni i Përhershëm i Kërkimeve Shkencore dhe Fatvave më datë 25/01/1418 h. nxori fetva në me numër 19402 për pyetjen që u bë në lidhje me këtë çështje.

Fetvaja është titulluar siç vijon:

Kush nuk i bën kafirë jehudët dhe të krishterët është kafir.

Falënderimi është për Allahun, salavatet dhe paqja është mbi të dërguarin, mbi shokët e tij dhe mbi ata që i ndjekin në të mirë deri në Ditën e Gjykimit.

Komisioni i Përhershëm i Kërkimeve Shkencore dhe i Fatvave mori në shqyrtim pyetjet që i kanë ardhur në lidhje me

çështjen e unifikimit të feve, e cila përhapet në mjete e informacionit; bëhet fjalë për fenë Islame, atë Jehude, Kristiane; dhe çështjet që rrjedhin nga kjo propagandë; si ndërtimin e xhamisë, kishës dhe sinagogës në të njëjtin shesh, pranë njëra tjetrës, në ambientet e universiteteve, aeroporteve dhe shesheve publike; po kështu propaganda për botimin e Kuranit, Teuratit dhe Ungjillit në një libër, si dhe pasoja të tjera që rrjedhin nga kjo propagandë. Për këtë çështje organizohen konferenca, simpoziume dhe ngrihen shoqata, në lindje dhe perëndim.

Komisioni i Përherëshëm pas vëzhgimit dhe studimit të kësaj çështjeje vendosi si më poshtë:

1 – Nga parimet e njohura domosdoshmërisht në besimin islam mbi të cilat janë pajtuar të gjithë muslimanët është se: Nuk ka fe të vërtetë në faqen e dheut veç fesë Islame dhe se ajo është vula

e feve dhe ajo është anuluese e të gjitha feve dhe legjislacioneve të mëparshme, atëherë nuk ka mbetur në faqen e tokës fe tjetër për të adhuruar Allahun me të veç fesë Islame. Allahu ka thënë: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë prej të humburve.”** (Ali Imran 85)

Pra është për qëllim feja që solli Muhamedi dhe jo të tjerat para saj.

2 – Nga parimet e besimit Islam është se Kurani është Libri i fundit që ka zbritur Allahu, ai është anulues i të gjithë Librave të mëparshëm si Teurati, Ungjilli etj., ai është ngadhënjyes mbi ta, atëherë nuk ka mbetur ndonjë libër i zbritur me të cilin adhurohet Allahu, veç Kuranit. Allahu thotë: **“Ne të kemi shpallur ty (o Muhamed) Librin (Kuranin) me të vërtetën, që është dhe si gjykues e mbizotërues ndaj tyre, ruajtës i parimeve të tyre, miratuesi**

**për ato që s’janë shfuqizuar, anulues i ligjeve që janë shfuqizuar. Prandaj gjykoi ata me atë që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e vërteta që të është shpallur.”** (Maide 48)

3 – Është detyrë të besohet se Teurati dhe Ungjilli janë libra të anuluar nga Kurani dhe se në to janë bërë deformime e ndryshime, duke u shtuar e pakësuar siç përmendet një gjë e tillë në disa ajete të Kuranit, prej tyre është fjala e Allahut: **“Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre. Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhamed) përherë do të vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice prej tyre...”** (Maide 13). Po kështu fjala e Tij: **“Me të vërtetë, një grup**

**ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre (ndërsa e lexojnë atë), që ju të mendoni se ai farë leximi është nga Libri (që ka zbritur Allahu), kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit. Ata thonë: ‘Kjo që lexojmë është nga Allahu’, por në të vërtetë nuk është nga Allahu. Ata flasin gënjeshtër për Allahun me vetëdije.’” (Ali Imran 78)**

Prandaj ajo pjesë nga librat e mëparshëm që ka mbetur e saktë (e pandryshuar) prej tij është anuluar nga Islami, ndërsa pjesa tjetër është e devijuar dhe e ndryshuar. Po kështu nga Profeti jonë Muhamedi (alejhi selam) është transmetuar se ai është zemëruar kur ka parë në dorën e Umer Ibn Hatab një fletushkë në të cilën kishte diçka nga Teurati. I ndërguari (alejhi selam) tha: “A je në dyshim ti o Ibn Hatab?! A nuk është ajo që kam sjellë unë e bardhë dhe e pastër, që

s'mund të ndryshohet, sikur vëllai im Musa të ishte gjallë nuk do të bënte tjetër vetëm se do të më ndiqte mua.” (trans. Ahmedi, Daremiu etj.)

4 – Nga parimet e besimit Islam është se i dërguari ynë Muhamedi (alejhi selam) është vula e të dërguarve, siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i dërguari i Allahut dhe vula e profetëve.”** (Ahzab 40). Atëherë nuk ka mbetur ndonjë i dërguar tjetër ndjekja e të cilit të jetë detyrë përveç Muhamedit (alejhi selam). Sikur ndonjë nga të dërguarit e Allahut të ishte gjallë, ai nuk do të bënte tjetër vetëm se do të ndiqte të dërguarin tonë Muhamedin (alejhi selam), prandaj pasuesit e tyre nuk duhet të bëjnë gjë tjetër, vetëm se të ndjekin Muhamedi (alejhi selam), siç ka thënë Allahu: **“Kujtoni (o ithtarët e librit) kur Allahu mori besëlidhjen nga**



profetët (dhe u tha): “Çfarëdo që t’ju jap prej Librit dhe urtësisë, kur të vijë një i dërguar (Muhamedi), vërtetues i asaj që u është dhënë, pa dyshim që ju duhet ta besoni dhe ta ndihmoni atë! (Allahu) tha: ‘A pranoni këtë dhe barrën që po jua ngarkoj?’ Ata u përgjigjën: ‘E pranojmë’. Allahu u tha: ‘Bëhuni dëshmitarë, se edhe Unë jam me ju dëshmitarë.’ (Ali Imran 81). Profeti Isa (alejhi selam) kur të zbresë në tokë në kohën e fundit do të ndjekë Muhamedin (alejhi selam) dhe do të gjykojë me Sheriatin e tij. Allahu ka thënë: “**Ata që ndjekin të dërguarin, Profetin (Muhamed) që nuk di shkrim e lexim, të cilin e gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre në Teurat dhe Ungjill**” (Araf 157).

Po kështu nga bazat e besimit Islam është se dërgesa e Muhamedit ka qenë përfshirëse për të gjithë njerëzit, Allahu ka thënë: “**Ne**

të kemi dërguar ty (o Muhamed) si përgëzues dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.” (Sebe 28). Po kështu thënia e Allahut të Madhëruar: **“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju.””** (Araf 158). E të tjera ajete që flasin për këtë.

5 – Nga parimet e fesë Islame është të besosh që çdo njeri që nuk ka hyrë në fenë Islame, qoftë jehud ose i krishter e të tjerë, quhet kafir dhe duhet të emërtohet kafir dhe se ai është aduv-v (kundërshtar) i Allahut, i të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, dhe se ai do të jetë banor i Zjarrit të Xhehenemit. Siç ka thënë Allahu i Madhërishëm: **“Ata që mohuan prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre) derisa t’u vinte Dëshmia e qartë.”** (Bejine 1). Po kështu Allahu ka thënë: **“Padyshim ata**

**që mohuan prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të jenë në Zjarr të Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.”** (Bejine 6). E të tjera ajete që flasin për këtë. Ndërsa i dërguari (alejhi selam) ka thënë: “Për Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk dëgjon për mua ndonjë prej këtij umeti, jehud apo kristian, pastaj vdes dhe nuk beson në atë me të cilën unë u dërgova, vetëm se do të jetë nga banorët e Zjarrit.”

Sipas kësaj që u përmend themi: Kush nuk i bën kafira, jehudët dhe kristianët, ai është kafir duke marrë për bazë rregullin e tërësishëm të Sheriatit: “Kush nuk e bën kafirin, kafir, ai është kafir.”<sup>(3)</sup>

---

<sup>(3)</sup> Ky rregull ka nevojë për më shumë sqarim, por nuk është vendi këtu. Rregulli bën fjalë për tekfir të pacaktuar, ndërsa kur është fjala për tekfirin e ndonjë muslimani të caktuar duhet shqyrtim e verifikim, pasi mund të ketë ndonjë pengesë tekfiri, psh, mund të jetë muslimani fillestar në fe ose mund të jetë

6 – Duke pasur parasysh këto baza të besimit dhe realitete të Sheriatit, propaganda për “Njësimin e Feve”, për afrimin ndërmjet tyre dhe shkrirja e tyre në një formë dhe paraqitje të vetme është një propagandë e poshtër intrigante. Kjo propagandë synon të përziejë të vërtetën me të kotën, të shkatërrojë Islamin dhe të shembë shtyllat e tij dhe t’i tërheqë muslimanët drejtë një dalje të përgjithshme

---

në një vend ku mbizotëron padituria dhe nuk e di se jehuditë dhe krishterët janë kafira, e kështu mund të justifikohet nga padituria e të mos bëhet kafir. Ibrahim i alejhi selam ka kërkuar falje për babain e tij dhe më pas e mësoi se Allahu nuk e falte babai e tij. Muhamedi alejhi selam kërkonte falje për nënën e tij dhe i fali namazin e xhenazes kreut të munafikëve, Abdullah Ibn Ubejjit, por këto ndodhën para se t’i vinte ndalimi për to. Këto argumente tregojnë për dy gjëra: Së pari, ka mundësi që muslimani të mos e dijë se nuk lejohet të lutesh për kafirin që Allahu ta falë, e po ashtu ka mundësi të mos e dijë se duhet t’i quaj kafira ithtarët e feve të tjera veç islamit dhe të mos e dijë se ata do të përfundojnë në Zjarrin e Xhehenemit nëse nuk pranojnë Islamin. Së dyti, nëse muslimani nuk është në dijeni mbi këto gjëra, ai është i justifikuar dhe s’mund të bëhet kafir.

nga feja. Vërtetësia e kësaj është në fjalën e Allahut: **“Ata vazhdimisht do të luftojnë kundër jush, që të mund t’ju kthejnë nga feja juaj (besimi islam), nëse kanë mundësi.”** (Bekare 217). Po kështu fjala e Allahut: **“Ata dëshirojnë që edhe ju të mohoni ashtu siç mohuan vetë dhe të bëheni të njëjtë.”** (En Nisa 89)

7 – Nga pasojat e kësaj propagande mëkatore është eliminimi i ndryshimeve mes Islamit dhe kufrit, të vërtetës dhe të kotës, të mirës dhe të keqes, dhe thyerjes së barrikadës ndërmjet muslimanëve dhe kafirëve. E kështu të mos ketë *vela* dhe *berra*, *xhihad* dhe *kital* për të ngritur lart fjalën e Allahut në tokën e Allahut, gjë që nuk përputhet me ajetin 29 të sures Teube dhe ajetin 36 po të sures Teube.<sup>(4)</sup>

---

<sup>(4)</sup> Termet *xhihad* dhe *kital* duhet të kuptohen në përputhje me kontekstin e tyre në Kuranë dhe në hadithet e Pejgamberit

8 – Propaganda për njësimin e feve, nëse rrjedh prej muslimanëve konsiderohet dalje e qartë prej fesë Islame, sepse kjo përplaset drejtë për së drejti me parimet e besimit Islam, kjo thirrje do të thotë të jesh i kënaqur të bësh kufër në Allahun, të bësh të pavlefshme vërtetësinë e Kuranit dhe faktin

---

dhe në përputhje me tërësinë e rregullave që lidhen me paqen dhe xhihadin në Islamë dhe që dalin po nga tekstet e shumta të Kuranit dhe Sunetit. Gjithsesi, ajetet e mësipërme vihen në zbatim veçse nga autoriteti i shtetit Islam në përputhje me ligjet që përcaktojnë gjendjen dhe marrëdhëniet mes këtij shteti dhe të tjerëve. Dijetarët që kanë nxjerrë këtë fetva i kanë bërë këto shpejgime në vende të tjera të fetvave të tyre, prandaj duhet t'i kemi parasyshë. Kështu, të gjitha pohimet që përmenden në pikën e mësipërme apo dhe në vende të tjera të këtij libri duhet të kuptohen në përputhje me thënien e Allahut: “Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët”. (Mumtehine 8). Ne nuk i quajmë vëllezër në fe ata të cilët nuk e besojnë Zotin ashtu siç e besojmë ne dhe që nuk janë muslimanë, por nga ana tjetër, ne bashkëjetojmë me ta në paqe, nuk u prekim jetën dhe pasurinë dhe sillemi në mënyrë njerëzore me ta, pa u bërë asnjë të keqe, madje u bëjmë dhe mirësi kur kemi mundësi.

që ai ka anuluar të gjithë Librat e mëparshëm dhe të bësh të pavlefshëm faktin që Islami i ka anuluar të gjitha legjislacionet dhe fetë e tjera para tij. Duke u bazuar në këtë që përmendëm ky është një mendim i refuzuar nga Sheriati, i ndaluar në mënyrë të prerë me të gjitha argumentet e Sheriatit Islam; të kuranit, Sunetit dhe ixhmasë.

9-

a – Muslimanit që beson në Allahun si Zot, në Islamin si fe dhe Muhamedin (alejhi selam) si i dërguar, nuk i lejohet që të ftojë në këtë ide mëkatore dhe as të nxisë për ta përqaftuar dhe përhapur atë ndërmjet muslimanëve dhe aq më tepër ta pranojë atë vetë, apo të marrë pjesë në konferencat dhe tubimet e tyre dhe të anëtarësohet në qarqet e tyre.

b – Muslimanit nuk i lejohet që të botojë Teuratin dhe Ungjillin më vete, atëherë si

mund të lejohet t'i botojë ato nën një kapak të vetëm libri së bashku me Kuranin! Ai që e bën këtë ose fton për ta bërë këtë është në humbje të sigurt, sepse kjo do të thotë të bashkosh ndërmjet të vërtetës (Kuranit) dhe të ndryshuarës ose të vërtetës së anuluar (Teuratit dhe Ungjillit).

c – Gjithashtu muslimanit nuk i lejohet t'i përgjigjet propagandës së ndërtimit të xhamisë, kishës dhe sinagogës në të njëjtin vend, sepse kjo do të thotë të pohosh se ka fe të tjera përveç fesë Islame, me të cilën mund të adhurohet Allahu dhe të mohosh ngadhënjimin e Islamit mbi fetë e tjera. Kjo është një thirrje materialiste që propagandon se ka tri fe dhe banorët e tokës mund të besojnë cilëndo prej tyre, dhe se ato janë të njëllojta, dhe se islami nuk i ka abroguar fetë e tjera para tij. Nuk ka dyshim se pohimi, besimi dhe pëlqimi i kësaj gjëje është kufër dhe humbje, sepse është kundërshtim i qartë



ndaj Kuranit, Sunetit të të dërguarit a.s. dhe ixhmasë. Kjo do të thotë të pohosh se devijimi i jehudëve dhe i kristianëve është nga Allahu, larg është Allahu nga kjo që thonë. Gjithashtu nuk lejohet që kishat të quhen shtëpi të Zotit dhe se ithtarët e tyre adhurojnë Allahun në to me një adhurim të saktë e të pranueshëm tek Allahu, sepse ky adhurim nuk është sipas fesë Islame, ndërsa Allahu thotë: “Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë prej të humburve” (Ali Imran 85). Madje ato janë shtëpi në të cilat bëhet kufër në Allahun, Allahu na ruajtë nga kufri dhe ithtarët e tij.

Shejhul islam Ibn Tejmije në “Mexhmua el fetaua” v.22 f. 126 ka thënë: “Kishat dhe sinagogat nuk janë shtëpi të Allahut, por shtëpi të Allahut janë vetëm xhamitë. Kishat dhe sinagogat janë shtëpi në të cilat mohohet Allahu edhe pse Ai mund të përmendet në to.

Shtëpitë vlerësohen sipas ithtarëve të tyre, ithtarët e tyre janë kafirë atëherë ato janë shtëpitë e adhurimit të kafirëve.”

10 – Nga çështjet që janë obligim të njihen është se: ftimi për në Islam i kafirëve në përgjithësi dhe i ithtarëve të Librit në veçanti është detyrë mbi muslimanët, kjo sipas argumenteve të qarta të Kuranit dhe Sunetit. Por kjo duhet të jetë me anë të sqarimit dhe dialogut me mënyrën më të mirë, pa toleruar në diçka nga ligjet e Islamit, në mënyrë që të binden për të hyrë në Islam, ose që t’u arrijë argumenti dhe të informohen mbi të vërtetën, me qëllim që ai që vdes të vdesë pasi është i mirinformuar dhe ai që jeton të jetojë i mirinformuar. Allahu ka thënë: **“Thuaj (o Muhamed): “O ithtarë të Librit: ‘Ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim),**

**dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut’. Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: ‘Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut.’** (Ali Imran 64). Ndërsa bisedimi dhe takimi me ta me qëllimin për të plotësuar dëshirat e tyre e për të realizuar objektivat e tyre dhe për prishjen e parimeve të Islamit dhe bazave të besimit, kjo është e papranueshme. E refuzon këtë Allahu, i dërguari i Tij dhe besimtarët. Allahu i kërkojmë ndihmë nga kjo që ata i përshkruajnë. Allahu ka thënë: **“Ki kujdes që ata mos të të nxisin të largohesh nga një pjesë e asaj që ta ka shpallur Allahu!”** (Maide 49)

Komisioni pasi ka vendosur kështu dhe ua ka sqaruar njerëzve, i porosit muslimanët përgjithësisht dhe të diturit veçanërisht që t’i frikësohen Allahut, të mbrojnë Islamin dhe besimin e muslimanëve nga humbja dhe propaganduesit e saj, nga kufri dhe

ithtarët e tij. U tërheq vërejtjen atyre nga kjo propagandë kufri e të humbur (Njësimi i Feve) dhe nga rënia në rrjetat e saj. Kërkojmë nga Allahu që ta mbrojë çdo musliman nga të qenit e tij shkak për sjelljen e kësaj humbje në vendet Islame dhe përhapjes së saj ndërmjet muslimanëve.

Lusim Allahun e lartësuar me Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e Tij të larta që të na mbroj të gjithëve nga fitnet (trazirat, shtrembërimet, ngatarresat e paqartësitë) që të humbin e të na bëjë ne udhëzues të drejtuar, mbrojtës të Islamit duke qenë në udhëzim dhe dritë prej Zotit tonë, derisa ta takojmë e Ai të jetë i kënaqur me ne. Me Allahun arrihet sukcesi; salavatet e Tij qofshin mbi të dërguarin tonë Muhamedin (alejhi selam) dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

## STUDIM

*Shkruar nga Ismail Bardhoshi*

**A është e vërtetë që Pejgamberi (a.s.) i ka lejuar krishterët të bëjnë meshë në xhami?**

**Çfarë gjykimi ka përdorimi i termit “harmoni ndërfitare”?**

**A ka rrezik të zbehët rruga e mesme e Profetit (a.s.) dhe sahabëve mes qëndrimeve me tendencë liberale dhe mes qëndrimeve me tendencë ekstreme?**

Lavdia i takon Allahut. Lavdërimi dhe Paqja qofshin për të Dërguarin e Allahut të Lartësuar, familjen e tij, sahabët dhe për të gjithë ata që pasojnë rrugën e tyre deri në Ditën e Kiametit.

Gjatë një emisioni televiziv një hoxhë kishte rrëfyer se një delegacioni krishterësh nga Abisinia kishin shkuar në Medine, dhe me lejen e Pejgamberit (a.s.), kishin mbajtur meshë në Xhaminë e tij. Ky delegacion krishterësh ishin ankuar se njerëzit nuk i kishin lejuar të mbanin meshë, dhe kështu Pejgamberi (a.s.) i kishte lejuar të bënin diçka të tillë në xhami. Ndërkaq, një vëlla që e kishte dëgjuar këtë emisionin më pyeti rreth vërtetësisë së këtij rrëfimi.

Kjo ngjarje sillet si argument për lejimin e krishterëve të mbajnë meshë në xhami si një dëshmi e të ashtuquajturës “harmoni ndërfetare” ose “përafrim i pikpamjeve dhe qëndrimeve ndërfetare”.

Në lidhje më këtë tregim dhe argumentimin me të, më duhet të bëj sqarimet e mëposhtme:

**Së pari**, në librat e jetës së Pejgamberit që unë kam në dorë si: “Siretu Ubn Hisham” etj, nuk e kam hasur tregimin e këtij delegacionit të Abisinisë për të parë në se është i saktë apo jo. Është e nevojshme të dimë se ku e ka burimin ky transmetim, në mënyrë që të shohim nëse është i saktë apo jo. Në të kundërt, në fenë islame tregimi që nuk ka sened, ose që nuk dihet se ku e ka burimin, ose që nuk është vërtetuar si i saktë, nuk ka asnjëfarë vlere argumentuese. Para se të sjellim një hadith për argument duhet të sigurohemi për saktësinë e tij. Abdullah Ibn Mubarek, siç shënon Muslimi në parathënien e *Sahih*-ut të tij, ka thënë: “Po të mos ishte senedi, kushdo mund të thoshte e të sajonte ç’të dëshironte”. Kështu, hoxhallarët që sjellin tregime që nuk dihen në se janë të sakta apo jo, duhet të bëjnë kujdes, sepse feja jonë nuk bazohet në pretendime, sajesa apo transmetime jo të sakta. Dikur para njëzet e ca vitesh në

Shqipëri njerëzit nuk e dinin se ka hadithe që janë të dobëta ose të trilluara, ndërsa sot, me mirësinë e Allahut, është bërë mjaft e lehtë t'u referohemi librave të hadithit, ose dijetarëve të hadithit, ose programeve kompjuterike për të mësuar nëse hadithi është i saktë apo jo. Prandaj, nuk i lejohet hoxhës të sjellë një tregim a një hadith të dobët, pa i sqaruar njerëzit që nuk është i saktë, sepse kjo do të thotë që t'i veshësh Pejgamberit diçka që nuk është prej tij.

**Së dyti,** ka një tregim tjetër të cilin e sjell Ibn Hishami në Sira (1/509) se Ibn Is'haku ka thënë: “Më ka treguar Muhamed Ibn Xhaferr Ibn Zubejr se: ‘Kur erdhi në Medinë delegacioni i Nexhranit, ata hynë në xhami, te Pejgamberi (a.s.), pas namazit të ikindisë. Ishte pikërisht koha e lutjes së tyre, prandaj ata nisën të kryenin ritet e tyre në xhami. Njerëzit donin t'i ndalonin, por Pejgamberi (a.s.) u tha: ‘Lërini!’ Ata u drejtuan për nga



lindja, dhe ashtu e kryen lutjen e tyre.”.

Përveç Ibn Hishamit, këtë tregim nëpërmjet Ibn Is’hakut, me të njëjtën rrugë, e shënon edhe: Ibn Xherir Taberiu në tefsir (3/163), Ibn Mundhir në tefsir (1/109) dhe Bejhakui në ‘Delailu Nubuveti (5/382)’.

Por ky sened ka ndërprerje. Muhamed Ibn Xha’ferr Ibn Zubejr nuk ka takuar askënd nga shokët e Pejgamberit.

Tha’lebiu e sjell në tefsir (3/6), edhe nga dy rrugë të tjera:

1. Muhamed Ibn Merrvan nga Kelebiu. Porse që të dy këta janë të akuzuar si gënjeshtarë.
2. Abdullah Ibn Ebi Xha’ferr Rraziu nga i ati, e ky nga Rrabi Ibn Enes. Ebu Xhefer Rraziu (i ati i Abdullahut që përmendet këtu) është i dobët. Kështu, ky është një murrسل i dobët.

Ibn Sa'di, gjithashtu, e sjell në 'Tabakatul kubra' nga Ali Ibn Muhamed, ky nga Ebi Masherri, ky nga Muhamed Ibn Xha'ferr dhe Muhamed Ibn Umarete Ibn Gazijete. Por edhe kjo rrugë ka disa probleme:

1. Për Ali Ibn Muhamed el kureshi el medeni nuk kam gjetur asnjëfarë vlerësimi.
2. Ebu Ma'sheri (Nexhiih Ibn Abdirrahman) është i dobët.
3. Muhamed Ibn Umaren Ibn Gazijen, që sipas kësaj rruge shoqëron Muhamed Ibn Xhaferrin në transmetimin e këtij hadithi, pra këtë person nuk kam arritur ta njoh. Sidoqoftë, kjo rrugë nuk e përforcon hadithin sepse përveç problemeve të mësipërme ka mundësi që të dy këta persona ta kenë sjellë hadithin nga të njëjtët transmetues të papërmendur, sepse siç u sqarua më lartë ky sened ka ndërprerje.

Si përfundim, ky është një hadith i dobët. Si i tillë nuk mund të merret për bazë si argument për çështjet e fesë.

**Së treti**, nuk lejohet që muslimanët të falën në kishë dhe as nuk lejohet tu jepet mundësi krishterëve të mbajnë meshë apo të kryejnë ritet e tyre në xhami. Muslimanët nuk e kanë të lejuar t'i kryejnë ritet fetare në të njëjtin vend me krishterët, me përjashtim të rastit të domosdoshmërisë kur muslimani nuk ka vend tjetër ku të falet.

Aishja radijallahu anha tregon: “Ummu Seleme dhe Ummu Habiba, r. anhuma, kishin qenë në Abisini. Ato përmendën bukurinë e kishës dhe statujat, skulpturat dhe ikonat që gjendeshin në kishën e tyre. Por Pejgamberi a.s. tha: “Vërtet, ata janë njerëz të tillë që, kur në mesin e tyre vdes një njeri i mirë, ndërtojnë mbi varrin e tij faltore, pastaj gdhendin ose bëjnë aty statuja, skulptura dhe

ikona. Ata, Ditën e Kijametit do të jenë më të këqinj të e krijesave për Allahun”. Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Duke shpjeguar këtë hadith, ndër të tjera, Ibn Rexhebi thotë: “(Këto fjalë të Pejgamberit) tregojnë se kishat janë shtëpi, ku zbret dënimi i Allahut mbi frekuentuesit e tyre, prandaj nuk i lejohet muslimanit të falet në to. Imam Ahmedi dhe Ebu Daudi sjellin një hadith të transmetuar nga Ibn Abasi se Pejgamberi ka thënë: “Nuk mund të bëhen bashkë dy kible (drejtime lutjesh) në një vend<sup>(5)</sup>”. Tavusi ka thënë: “Nuk duhet që shtëpia e mëshirës të jetë pranë një vendi dënimi. Ebu Ubejd dhe të tjerë e shpjegojnë hadithin e sapopërmendur me kuptimin që nuk duhet të bëhen bashkë xhamiat dhe kishat në një vend. Përderisa ndërtimi i objektit të xhamisë dhe kishës në të njëjtin vend është i ndaluar, atëherë është edhe më e arsyeshme të ndalohet kryerja e ritit të

---

<sup>(5)</sup> Hadithi është i dobët.

faljes, për të cilin janë ndërtuar xhamiat, në të njëjtin vend me ritet e kufrit, që kryhen në kisha. Ashtu siç nuk ju jepet mundësi krishterëve ti kryejnë ritet e tyre në xhamia, po kështu nuk duhet që muslimanët t'i falin namazet në tempujt e kafirave, të cilat në fakt janë vendet e kufrit të tyre. Por dikush këtu mund të thotë se ka një transmetim që tregon se lejohet të lihen krishterët të kryejnë ritin e tyre të faljes në xhamitë e muslimanëve. Përderisa kjo lejohet, atëherë në mënyrë më parësore ju lejohet muslimanëve të falin namazin në kishat e tyre. Ibn Is'haku rrëfen se i ka treguar Muhamed Ibn Xhaferr Ibn Zubejr se: 'Kur erdhi në Medinë delegacioni i Nexhranit, ata hynë në xhami, te Pejgamberi (a.s.), pas namazit të ikindisë. Ishte pikërisht koha e lutjes së tyre, prandaj ata nisën të kryenin ritet e tyre në xhami. Njerëzit donin t'i ndalonin, por Pejgamberi (a.s.) u tha: 'Lërini!' Ata u drejtuan për nga lindja, dhe ashtu e

kryen lutjen e tyre.” Si kundërpërgjigje ndaj këtij transmetimi ne themi se senedi i tij ka ndërprerje, dhe si i tillë është i dobët. Por edhe sikur ku transmetim të ishte i saktë, ai tregon se Pejgamberi e bëri këtë gjë vetëm për të fituar zemrat e tyre, nga frika se mos ata largoheshin nga Islami. Përderisa nuk ka nevojë më për diçka të tillë, nuk lejohet t’u jepet mundësi krishterëve për diçka të tillë” [Fet’hul Bari i Ibn Rexhebit].

**Së katërti**, nuk lejohet dhe as nuk ka nevojë që për të treguar tolerancë fetare të lejohen krishterët të mbajnë meshë në xhami apo të shkojnë muslimanët të falin namazin në kishë. Kjo gjë:

- Mund të çojë deri aty sa që të mos ketë ndarje dhe diferencë të qartë për njerëzit e paditur mes fesë së vërtetë e të pranuar tek Allahu dhe mes feve të pavërteta, sidomos në një vend si Shqipëria ku njerëzit nuk janë të mirëinformuar mbi

çështjet e fesë dhe ku një pjese që janë indiferentë ndaj fesë ju duken të gjitha fetë njësoj.

- Bie ndesh me parimin e ballafaqimit mes të vërtetës dhe mes të pavërtetës, mes rrugës së drejtë dhe rrugës së shtrembër, në nivel dialogu, me qëllim që të bëhet e qartë e vërteta dhe të përhapet tek njerëzit. Në mungesë të këtij ballafaqimi, ose zbehjes së tij, njerëzit e kanë të vështirë të dallojnë të vërtetën nga e pavërteta dhe kjo mund të bëhet edhe pengesë për përhapjen e të vërtetës, sidomos në vendin tonë, ku një pjese njerëzish thonë se fetë janë njësoj.
- Mund t'u shërbejë edhe kundërshtarëve të Islamit të cilët synojnë që feja ta humbë përmbajtjen e saj të vërtetë, të mos ketë ballafaqime ndërfitare, qoftë dhe në nivel dialogu, dhe marrëdhëniet

ndërnjerëzore të mos rregullohen nga feja. Prandaj, kundërshtarët e Islamit e vënë theksin tek shkëmbimi i vizitave mes titullarëve të feve të ndryshme nëpër festa, “harmonia fetare”, “toleranca fetare”, “përafrimi mes feve”, “mesazhi i përbashkët fetar”, qëndrimi këto të cilat në sytë e një pjese të publikut tonë shihen si punë feshë që nuk kanë ndonjë ndryshim! Të mos harrojmë ballafaqimin e Pejgamberëve në dialog me kundërshtarët e tyre për të dalë në shesh e vërteta. Dialogjet dhe bisedat e Pejgamberëve me kundërshtarët janë përmendur në Kuranë. Pejgamberi ynë u ballafaqua me kundërshtarët e tij në fe, në Meke, me dialog, biseda, këshilla, tregime dhe mesazhe hyjnore, duke mos bërë lëshim në këtë parim, megjithse idhujtarët ishin të interesuar që të mos



ekzistone ky ballafaqim. Kush e njeh jeten e Pejgamberit në periudhën e Mekës, këtë e ka fort të qartë.

Por dikush mund të na kundërshtojë me pretendimin se dijetarët e kanë lejuar këtë gjë nëse shihet e nevojshme dhe nuk bëhet diçka e rregullt: Ibn Kajim thotë: “Tregimi i delegacionit të Nexhranit dëshmon se në ndonjë rast të paparashikuar, mund tu jepet mundësi *ehlul kitab*-ëve të kryejnë ritin e lutjes së tyre në xhami, në prani të muslimanëve; por jo që të bëhet rrugë e rregull diçka e tillë” [Zadul Mead]. Ibn Rexhebi në citatin e mësipërm thotë: “Por edhe sikur ky transmetim të ishte i saktë, ai tregon se Pejgamberi e bëri këtë gjë vetëm për të fituar zemrat e tyre, nga frika se mos ata largoheshin nga Islami.” Kështu, mund të hidhet ideja se kjo gjë është e nevojshme për të treguar tolerancë fetare!

### Kundërpërgjigja:

a. Ibn Kajim e bazon konkludimin e tij mbi transmetimin e mësipërm i cili siç u sqarua nuk është i saktë, kështu që nuk vlen për argument. Prandaj dhe Ibn Rexhebi i cili është një nga nxënësit e Ibn Kajimit e hedh poshtë bazimin në këtë hadith për këtë çështje pikërisht me faktin se është i dobët.

b. Rasti i nevojës që përmend Ibn Rexhebi ka të bëjë me fitimin e zemrave të krishterëve për të hyrë në Islam, e jo për të treguar “harmoni e përafrim ndërfeetar”! Të njëjtin qëllim si Ibn Rexhebi ka edhe Ibn Kajim.

c. Të drejtat e ithtarëve të feve të tjera në vende si Shqipëria i mbron ligji dhe shteti ekzistues. Kështu që për t’u treguar ithtarëve të feve të tjera se ne nuk ju prekim të drejtat që ju garanton shteti nuk ka asnjë nevojë të lejohen të mbajnë meshë në xhami ose që muslimanët të falen në kishë.

d. Pejgamberi ynë ka bërë marrëveshje paqeje me disa komunitete jomuslimanësh në Medine. Muslimanët ndër shekuj, sidomos në vendin tonë, kanë ditur dhe kanë pasur aftësinë të jetojnë në paqe me komunitetet e tjera fetare, në saj të mësimëve tolerante të Islamit, pa e parë aspak të nevojshme të lejojnë krishterët të mbajnë meshë në xhami. Ndërsa sot në vendet ku qeverisjen e kanë kafirat, nuk ka kuptim të kërkohet tolerancë nga muslimanët se nuk kanë gjë në dorë, por duhet tu kërkohet kafirave të tregohen tolerantë me muslimanët dhe të respektojnë të drejtat e tyre. Nisur nga ky fakt, të bën habi se përse duhet që ta ngrejne më shumë zërin muslimanët për tolerancë, duke i pranuar në njëfarë mënyrë paragjykimet dhe shpifjet e kafirave për intolerancë të muslimanëve, ndërkohë që tolerancën tashmë duhet ta tregojnë vetë kafirat.

h. Bashkëjetesa në paqe me ithtarët e feve të tjera, mirësjellja me ta, mirëbërja ndaj tyre dhe respektimi i të drejtave të tyre mund të realizohen pa qenë aspak e nevojshme që të kryhen ritet në të njëjtin vend, që krishterët të mbajnë meshë në xhami dhe muslimanët të falin namaz në kishë, apo që titullarët fetarë të marrin pjesë në festat e njëri-tjetrit dhe të urojnë njëri – tjetrin për to. Përkundrazi, këto të fundit mund të prekin mëvetësinë dhe karakteristikat e secilës fe, madje mund të krijojnë atë idenë e cekur më sipër tek një pjesë e njerëzve indiferentë ndaj fesë se nuk ka ndryshim mes feve apo se fetë janë njësoj!! Ndryshueshmëria, karakteristikat, veçoritë, thirrja, parimet dhe synimet unike që kemi si ymet islam duhet të na bëjnë të ndihemi krenarë, dhe ti ruajmë ato me çdo kusht e çdo çmim, e jo ti shkrijmë ato para syve të njerëzve, duke ju përgjigjur thirrjeve intrigante të “përafrimit të feve” që kanë si

qëllim mënjanimin e islamit nga realiteti i jetës dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore.

n. Për të gjitha ato që u thanë më lart kjo ide bie ndesh me synimet e Sheriatit; jo vetëm që nuk i favorizon muslimanët dhe nuk realizon ndonjë dobi për ta, por shkakton dëme për thirrjen e vërtetë, thirrjen e teuhidit, thirrjen që bënë të gjithë Pejgamberët e Allahut.

**Së pesti**, duhet ti ftojmë kafirat në përgjithësi, dhe ithtarët e librit në veçanti në fenë Islame me dialog në mënyrën më të mirë. Dialogu bëhet me qëllim që të dalë në shesh e vërteta, që njerëzit të përqafojnë islamin e të heqin dorë nga shirku, por jo për përafrimin e feve e për të bërë lëshime në fe apo shtrembërime të çështjeve të Islamit. Muslimanët që bëjnë dialog me ithtarët e librit në kohën tonë ndahen në dy grupe:

1 – Ata që i ftojnë ithtarët e librit nëpërmjet dialogut të pranojnë islamin.

Këta kanë si qëllim të dalë në pah e vërteta dhe të mposhtet e kota. Këta vënë në zbatim fjalën e Allahut: “Thuaj (o Muhamed): “O ithtarët e Librit: “Ejani të biem në një fjalë të drejtë e të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim), dhe se njëri-tjetrin nuk do ta mbajmë për zot, në vend të Allahut’. Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: ‘Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut si muslimanë” [Ali Imran: 64]. Ky është dialogu i drejtë dhe i duhur me ithtarët e librit. Por dialogun me mënyrën më të mirë e më të arrirë mund ta bëjnë veçse ata që kanë dituri e aftësi.

2 – Ata që bëjnë dialog për të ashtuquajturën “harmoni fetare” ose “përafrim mes feve”. Këta njerëz bëjnë lëshime në fe, shtrembërojnë mësimet dhe rregullat e islamit, keqintepretojnë argumentet e tij. Qëllimi i një dialogu të tillë

nuk është që të dalë në shesh e vërteta dhe që ithtarët e librit të pranojnë islamin, por që të eliminohet ballafaqimi mes të vërtetës dhe të pavërtetës. Ky lloj dialogu është i pavlerë; nuk është ky dialogu për të cilin na ftojnë argumentet e fesë, përkundrazi, ky lloj dialogu shtrembëron argumentet. Por lejohet ulja dhe bisedimi me ithtarët e librit për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të muslimanëve, ose për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e përbashkëta kundrejt një palë të tretë që dëmton si muslimanët edhe *ehlul kitab*-ët, ose për të bërë një marrëveshje që shihet e domosdoshme për interesat e muslimanëve apo që është në favor të muslimanëve.

**Së gjashti**, duhet të jemi të kujdesshëm në termat që përdorim për të treguar bashkjetesën në paqe me jomuslimanët apo respektimin e të drejtave të tyre. Për të shprehur këtë duhet të zgjedhim fjalë që

nuk përmbajnë kuptim të prapranueshëm në fenë tonë, ose që nuk mund të keqpërdoren ose të keqshpjegohen nga njerëzit. Duhet ti zgjedhim ne shprehjet dhe jo të na i diktojnë kafirat ose t'i marrim të gatshme prej tyre, se kafirat nuk shohin se bie ndesh fjala e përdorur me fenë apo jo, se jep kuptim të pranueshëm apo jo, se mund të keqkuptohet apo jo; për kafirat rëndësi ka që të realizohen planet e tyre. Fjala vjen, shprehja “harmoni ndërfitare” jep kuptim e përputhjes, ose përshtatjes së natyrshme mes pjesëve përbërëse të diçkaje, ose pajtimit në mendime e në qëndrime me dikë, ose mirëkuptimi dhe marrëdhëniet miqësore. Kështu shpjegohet kjo fjalë në Fjalorin e Shqipësisë së Sotme. Siç shihet kjo fjalë përmban kuptim të prapranueshëm në fenë tonë, sepse nuk ka përputhje mes të vërtetës dhe të pavërtetës. Ideja se ka përshtatje të natyrshme mes fesë së vërtetë dhe mes feve të kota, përsëri



është e gënjeshtërt. Pajtimi në mendime dhe në qëndrime me fetë e tjera, pa kufizim e pa përcaktim, nuk është i saktë. Mirëkuptimi dhe marrëdhëniet miqësore me kafirat, po të merren me kuptimin e tyre të drejtëpërdrejtë e të gjithanshëm , nuk mund të pranohen si të sakta, e nëse do të bëhet ndonjë përcaktim ose shkoqitje, atëherë duhet parë se me çfarë kuptimi dhe në cilin aspekt përdoren. Pra, edhe me kuptimin e fundit termi “harmoni fetare” lë shumë hapësirë për keqkuptim dhe keqshpjegim e keqpërdorim. Prandaj, duhet të përdoren fjalë të pranueshme si: tolerancë<sup>(6)</sup> ndaj jomuslimanëve, mirëbërja

---

<sup>(6)</sup> Fjala tolerancë është e barasvlefshme me fjalët “semaha” ose “tesamuh” ose “semha”, pra është përkthim i kësaj fjale arabe dhe i këtij koncepti fetar. S’ka dyshim që në fenë isalme ka tekste fetare dhe norma ligjore për tolerimin e ithtarëve të librit në veçanti dhe kafirave në përgjithësi në disa gjëra, jo vetëm në kushtet e vendit tonë, por dhe nën hijen e shtetit islam. Ka kushte, aspekte apo gjëra ku tolerohen jomuslimanët, ka aspekte ku tregohemi tolerantë ndaj tyre. Por gjërat ku tregohemi tolerantë me ta, aspektet e tolerimit,

dhe mirësjellja ndaj tyre, respektimi i te drejtave të jomuslimanëve të përcaktuara në marrëveshjet e lidhura me ta, ose të garantuara nga shteti dhe ligji ekzistues, bashkëjetesa në paqe me jomuslimanët, marrëdhëniet paqësore. Këto shprehje ose këto përdorime kanë kuptim të pranueshëm dhe mund të gjeshë bazë për to në tekstet e Kuranit ose të Sunetit.

**Së shtati**, por si gjykohet për muslimanin që përdor termin “harmoni ndërfitare”?

---

etj., përcaktohen veçse në bazë të argumenteve të Kuranit dhe Sunetit. Të jeshë tolerant me jomuslimanët në kushtet tona, ndër të tjera, do të thotë: të jetosh në paqe me ta, të mos u bësh padrejtësi, të mos i dhunosh për pranimin e Islamit, t’u bësh mirë, të sillesh mirë dhe me mëshirë me ta, tu bësh dhurata, tu japësh sadaka (lëmoshë) të varfërve të tyre, t’i përshëndesësh kur i takon, t’u bësh vizitë kur sëmuren, t’u bësh vizitë dhe t’i ngushëllosh kur u vdes ndonjë i afërm apo mik, të ruash fqinjësinë e mirë me ta, të ruash lidhjet farefisnore me kafirat që i ke fis. Kështu, tolerance ndaj tyre s’do të thotë të bëjmë tolerime në marrëdhëniet me ta aty ku nuk e lejon feja islame, por veçse në gjërat ku e lejon ose i cakton feja islame.

Duhet parë se me çfarë kuptimi e përdor:

- Nëse e përdor më një kuptim që është kufër, atëherë bën kufër. Por për shpalljen e një personi të caktuar si kafir duhet të shqyrtohet plotësimi i kushteve dhe mungesa e pengesave, pasi mund të ketë ndonjë pengesë ose mund të mos jetë plotësuar ndonjë kushtë për ta shpallur si kafir.
- Nëse e përdor me një kuptim të papranueshëm, që bie ndesh me normat e fesë Islame, por që klasifikohet si haram, ose si gjynah, ose si bidat, e jo si kufër, në këtë rast themi se ka shprehur një ide të ndalur ose që ka përqaftuar një bidat në fe.
- Nëse muslimani e përdor me një kuptim të pranueshëm, si përshebull për marrëdhënie paqësore, për respektimin e të drejtave, ose për mirësjellje e

mirëbërje ndaj kafirave, në këtë rast duhet ta bëjmë me dije këtë musliman se edhe pse ka pasur për qëllim një kuptim të pranueshëm, duhet të heqë dorë nga përdorimi i këtij termi, sepse kuptimi i drejtpërdrejtë i tij është i keq dhe i papranueshëm dhe sepse ky term lë shumë hapësirë për keqshpjegim dhe keqpërdorim.

Kështu që kur një musliman e përdor këtë term nuk mund ta nxjerrim nga feja dhe as nuk mund të japim ndonjë gjykim për të, pa parë se me çfarë kuptimi e ka përdorur. Por gjithsesi duhet të kërkohet prej tij të heqë dorë nga ky përdorim i keq. Nuk janë të paktë hadithet që na mësojnë etikën e të shprehurit sidomos në çështjet e besimit.

**Së teti**, po nëse dikush bën lëshim ose shtrembërim në çështjet e fesë, duke iu përgjigjur kërkesës së kafirave, si gjykohet?

- Nëse bën një lëshim apo një shtrembërim që konsiderohet kufër, ky bën kufër. Por për shpalljen e një personi të caktuar si kafir duhet të shqyrtohet plotësimi i kushteve dhe mungesa e pengesave.
- Nëse bën një lëshim ose një shtrembërim që është shkelje ose bidat, ky klasifikohet si gjynahar ose si bidatçi, por kjo në parim, pasi për gjykimin ndaj personave të caktuar duhet të bëhet më shumë shkoqitje dhe duhet më shumë kujdes. Nuk mund të përjashtohet mundësia, përshembull, që një musliman ta ketë bërë një gjynah në kushte domosdoshmërie, ose nga padituria që karakterizon një musliman që është në fillimet e pranimit të islamit. Kështu, nuk duhet të nxitohemi duke e quajtur (fasik) një musliman të caktuar, pa e shqyrtuar mirë çështjen e tij. Një rregull islam thotë se kushtet e domosdoshmërisë mund të bëjnë të

lejueshme gjërat e ndaluara. Sipas një rregulli tjetër, nëse një musliman e bën një gjynah nga padituria, ai është i justifikuar, përderisa hynë në kategorinë e atyre që mund të justifikohen. Kur flasim për persona të caktuar duhet të mos nxitohemi në gjykim, sidomos në kushtet e trojeve tona, ku janë fshirë shumica e gjurmëve të profecisë. Është e vërtetë që ka njerëz të cilët i keqpërdorin rregullat e porsapërmendur duke i vënë jo në vendin e duhur, dhe pikërisht ky material këtu po përqëndrohet, por nuk lejohet të biem në devijimin tjetër duke gjykuar ndaj muslimanëve padrejhtësisht e pa respektuar rregullat.

- Nëse bën lëshim ose vepron diçka që është e ndaluar si masë parandaluese, ose si një gjynah i vogël, ose në diçka që është mekruh, këtu nuk duhet të nxitohemi të gjykojmë për një musliman

të caktuar, sepse mund të ketë ndonjë justifikim të pranueshëm në fe. Një rregull thotë se gjërat e ndaluara si masë parandaluese (*sedden lidherriati*) mund të lejohen në rast nevoje, por me kusht që të ketë siguri se nuk do të shkaktohet gjynahu ose dëmi për të cilin ato janë ndaluar. Edhe njëherë e përsëris që ka njerëz të cilët i keqpërdorin këto rregulla ose nuk i kanë parasyshë fare kur bëjnë lehtësime e lëshime në çështjet e fesë; mbase ata nuk nisen fare nga rregulla të tilla. Nuk është vendi këtu për të dhënë shembujt e përdorimit të saktë të këtij rregulli dhe as të keqpërdorimit të tij. Këtu mjafton të tërheq vëmendjen se nuk duhet të nxitohemi për të gjykuar ndaj një muslimani të caktuar, sidomos kur bën një gjynah të vogël apo diçka të ndaluar si masë parandaluese (*sedden lidherriah*) në vende si këto të tonat, pasi

ka mundësi të përfshihet në rregullin e përmendur këtu.

**Së nënti,** kohët e fundit, duke shfrytëzuar disa pikpamje ekstreme apo të teprimit në punët e fesë, media i ka dhënë shumë hapësirë mendimit me prirje liberale, properëndimore, që me sa duket bëhet me qëllimin që të përhapen mes muslimanëve bidatet dhe idetë liberale. Pikpamjet e teprimit dhe të ekstremimit janë të papranueshme për shumicën e njerëzve, sepse bien ndesh me fitra-n, përveç që shumica gjithmonë anon nga lëshimi, lehtësimi dhe plotësimi i dëshirave. Nëse do të vihen në fokus vetëm dy mundësitë: ose pikpamjet ekstreme ose pikpamjet liberale, duke lënë krejt në harresë rrugën mesatare të ehli sunetit, ka rrezik të përhapen pikpamjet e xhematit “liberal” mes muslimanëve, pasi mesataria e ehli sunetit mund të bëhet e paqartë për ta, në mes të fokusimit intrigant tek dy kahet ekstreme.



A do të lejojnë hoxhallarët dhe xhemati i muslimanëve të zbehet qëndrimi mesëm i ehli sunetit mes pikpamjeve ekstreme dhe pikpamjeve të rrymës liberale në favor të kësaj të fundit? Kjo është një nga sfidat e ditëve të ardhshme përpara ehli sunetit. Allahu e di më mirë.

**Së dhjeti**, sa për shembull po përmend disa qëndrime me prirje liberale dhe disa të tjera me prirje ekstreme:

**Disa qëndrime me tendencë liberale:**

- Lejimi i krishterëve të bëjnë meshë në xhami, dërgimi i rinisë islame në kishë, teqe, me preteksin se do bëhet harmoni apo bashkëpunim ndërfeetar.
- Pjesëmarrja në meshë.
- Mbledhja e rinisë islame në një vend me atë të feve të tjera për zhvillimin

e aktiviteteve kulturore e argëtuese, me qëllim që të njihen me njëri-tjetrin, ndërkohë që tubime të tilla nuk janë të domosdoshme për ruajtjen e domosdoshmërive jetike të muslimanëve dhe as nuk kanë të bëjnë me gjëra që janë në interes të përbashkët për muslimanët dhe komunitetet e tjera fetare.

- Përqëndrimi i bisedave vetëm tek ekzistenca e një Krijuesi, paqja, mëshira, dashuria, harmonia ndërfitare, humanizmi, bukuria, pastërtia, vëllazëria ndërfitare. Këto biseda mund t'i dëgjosh edhe nga titullarët krishterë liberalë! Atëher, ç'ndryshim ka ligjërimi i një muslimani nga ai i titullarëve të feve të tjera? Harmonia, humanizmi dhe vëllazëria ndërfitare janë terme të papranueshëm, siç u sqarua dhe më lart. Ndërsa termat dhe temat e tjera janë të sakta, por nuk lejohet shtrehtërimi

i tyre për t'i vënë në shërbim të ideve dhe qëndrimeve liberale. Këtu nuk dua të them se nuk ka gjëra ku ne biem në ujdi me fenë e krishterë. Po ashtu nuk e kam qëllimin se nuk ka çështje ku puqen interesat e muslimanëve dhe krishterëve dhe ku mund të bashkëpunohet me ta. Por nëse diskutimi i një thirrësi në Islam gjatë dialogut me kafirat bëhet në një mënyrë të tillë që nuk ngjall asnjë lloj kundërshtimi ndaj besimit, parimeve, vlerave, normave morale, ligjeve dhe riteve islame, atëherë çfarë mesazhi islam ka arritur ky thirrës t'u përcjellë mosbesimtarëve!? Kur gjërat që trajton një musliman nuk i trazojnë fare kundërshtarët, kafirat, idhujtarët, të shtururit dhe imoralët; kjo tregon se këto gjëra ose nuk qëndrojnë ose nuk janë përcjellë siç duhet ose nuk prekin asnjë pikë kundërshtie me ta. Nuk duhet

të jetë qëllimi i bisedës fetare thjesht të marrim pëlqimin e kafirave apo njerëzve të prishur, por udhëzimi i tyre në Islam. Thirrja islame nuk duhet të ketë si objektiv plotësimin e tekave dhe dëshirave të njerëzve, por ndryshimin e gjendjes së tyre dhe kalitjen a frenimin e dëshirave të tyre. Natyrisht, ndryshimi i gjendjes së njerëzve dhe frenimi i dëshirave të tyre do të bëhet shkallë-shkallë, duke filluar me gjërat më të rëndësishme, më të qartë e më të kuptueshme. Thirrësi duhet të thotë ato gjëra që kënaqin Zotin qoftë edhe nëse nuk i pëlqejnë njerëzit; duhet të kërkojë të kënaqë Allahun e Lartësuar, qoftë edhe duke hidhëruar njerëzit. Nëse në një kuved, ku ka njerëz imoralë, përshembull, nuk mund të flitet për mjetet e masat e ruajtjes së nderit, aty mund të flitet për ruajtjen e nderit si një vlerë dhe mund të kalohen në heshtje

mjetet dhe mënyrat e ruajtjes së nderit. Ndërsa të lihen njerëzit e shturur të qeshin e të gajasen me rregullat e islamit e të mos u thuhet asgjë për ruajtjen e nderit si një vlerë, kjo nuk më duket një taktikë e urtë. Njerëzit e kanë në natyrë (*fitra*) besimin në ekzistencën e Allahut; mohimi i ekzistencës së Krijuesit është kokfortësi. Kështu, biseda rreth ekzistencës së Krijuesit, pa e shoqëruar me thirrjen për ta adhuruar Atë të vetëm pa i bërë shok dhe thirrjen për largimin nga shirku, nuk ka dobi. Në format e shumta të shirkut hyjnë edhe ato të përhapura tek krishterët. Gjatë periudhës së Mekës Profeti është përqëndruar në tema të tilla si: teuhidi, largimi nga shirku, besimi në Ditën e Gjykimit, pranimi i profetësisë së Muhamedit (a.s.), pranimi i Kuranit si fjalë e Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, respektimi

i prindërve, ruajtja e nderit, çiltërsia, vërtetësia, mbajtja e besës, mbajtja e amanetit, ruajtja e lidhjes me farefisën, fqinjësia e mirë, drejtësia, përkrahja e të dobtëve dhe të shtypurve, mirëbërja, morali i mirë, ndalimi i imoralitetit dhe paturpësive, ndalimi i vrasjes pa të drejtë etj.. Shih ajetet e para të sures el Mudeth-thir, suren el En'am: 151-153 dhe suren el Isra: 23-29. Shih edhe hadithin e Abdullah Ibn Abasit që e tregon nga Ebu Sufjani [Buhari: 7 dhe Muslimi: 1737]. Po ashtu shih edhe hadithin e Amër Ibn Abeses [Muslimi: 832]. Gjithashtu shih dhe hadithin e Umu Selemes e cila citon fjalët që tha Xha'ferri Ibn Ebi Talib në kuvendin e Nexhashiut, mbretit të Abisinisë (Ahmedi: 1740, 3/267).

- Shmangia e citimit të ajeteve të Kuranit në arabisht, madje shmangia e përmendjes së emrit të Zotit "Allah", për të mos

prekur ndjenjat e bashkëkombësve duke përmendur terma e fjalë arabe!

- Pjesëmarrja në studio a emisione televizive ku ka femra gjysmëlakuriq, saze e sazexhinj dhe ku përqëndrimi i njerëzve është tek pamjet e femrave gjysmëlakuriq e këngët dhe meloditë muzikore. Kjo bëhet me preteksin se gjoja do thirren njerëzit në Islam apo se do shpalosen vlerat e Islamit! Nuk ka ndonjë hadith që tregon se Profeti ka marrë pjesë në mexhlise sazesh, këngësh e lakuriqësie, me qëllimin për t'i ftuar njerëzit në Islam. Ndërsa lëvizja e Pejgamberit (a.s.) nëpër rrugët e tregjet e Mekës nuk vlen si argument për këtë gjë, sepse asokohe në Mekën e nderuar shtëpitë apo vendet e sazeve dhe femrave gjysmëlakuriq ishin veças, ndërsa nëpër rrugë e tregje njerëzit kishin angazhime dhe punë të ndryshme. Përveç kësaj,

është e pavend t'u drejtosh thirrjen islame njerëzve të dehur ose atyre që janë të shastisur pas sazeve, këngës dhe femrave gjysmëlakuriq. Kjo nuk tregon urtësi në thirrje.

- Zbutja e qëndrimit ndaj rrafidive (shi'itëve), tarikateve (sekteve) të sufizmit dhe mbarë grupeve të humbura. Në këtë kontekst, bëhen edhe kritika ndaj fetvave të dijetarëve të medhenj të cilat flasin kundër rrafidive. Tashmë vërehet qartë që qarqet perëndimore po favorizojnë shiitët dhe itharët e sekteve sufiste, me qëllimin e keq për të shfrytëzuar rrugët e devijuara kundër rrugës islame të drejtë të ehli sunetit. Kështu që zbutja e qëndrimit bëhet për të kënaqur njerëzit me influencë në vendimmarrje.
- Lavdërimi i kokave të bidatit dhe kokave të rrymave liberale mes muslimanëve, duke i konsideruar ata si dijetar.



- Konsiderimi i besimit fetar si faktor që na bashkon me ithtarët e feve të tjera dhe jo si faktor që na ndan.
- Pjesëmarrja në aktivitetet fetaro-kulturore të krishterëve, siç është përshembull pjesmarrja në ngritjen e bustit të ndonjë murgeshe të tyre që ata e mbajnë për shenjtorë etj.
- Konsiderimi i krishterëve si vëllezër, urimi i tyre për festa, si dhe vajtja për t'i uruar ata në kishë.
- Nxitja e muslimanëve për t'u punësuar në punë që janë haram apo që janë në shërbim të zullumqarëve, ose që kanë të bëjnë me marrje vendimesh a zbatim të ligjeve që bien ndesh me Sheriatin. Po kështu është dhe nxitja e muslimanëve të antarësohen në partitë politike. Këtu pra po flas për nxitjen e atyre që nuk janë në mjedise të tilla për të hyrë në to. Kështu

nuk e kam fjalën për ndonjë përjashtim të matur mirë që mund të bëhet për ndonjë që ka pranuar Islamin apo është kapur për fenë, duke qenë në këto mjedise, ose për tolerimin dhe heshtjen ndaj dikujt që është në hapat e para të Islamit e që gjendet në këto mjedise të këqija.

- Pretendimi se muslimanët mund të marrin pjesë me krishterët në ndërtimin e kishës.
- Thirrjet dhe propaganda nacionaliste e patriotike dhe ngritja a përdorimi i simboleve të tilla, ndërkohë që s'ka domosdoshmëri për gjëra të tilla. Lejohet të përdoren dokumentat dhe mjetet që përmbajnë simbole të tilla në rast domosdoshmërie a nevoje. Po ashtu lejohet të përmenden thirrje që përmbajnë përkatësi kombëtare ose fisnore në rast domosdoshmëria a nevoje. Gjithashtu lejohet të përmendësh fisin,

popullin, vendin apo krahinën që i përket për t'u njoftuar me njerëzit apo që të të njohin njerëzit. Por shfaqjet, thirrja dhe propaganda për kombëtari, nacionalizëm dhe patriotizëm, kur s'janë të nevojshme, janë haram. Ky është qëndrimi i mesëm në këtë çështje dhe kështu harmonizohen të gjitha argumentet që flasin për këtë temë.

- Pretendimi se ka islam evropian, apo me botëkuptim evropian, dhe islam arab, apo me botëkuptim radikal arab!
- Pretendimi se ka islam tradicional shqiptar kundrejt një islami te ashtuquajtur radikal arab a turk, dhe se duhet të ndiqet islami tradicional shqiptar!

## **Disa qëndrime me tendencë ekstreme:**

- Kur njeri i quan kufër të madh disa gjëra që sipas besimit të ehli sunetit nuk janë kufër, siç është pjesmarrja e muslimanët në votime, hapja e padisë në gjykatën laike etj.. Por kjo çështje ka nevojë për më shumë shkoqitje.
- Kur dikush bën kafira muslimanët, bazuar në devijimet e havarixhëve, ose pa shqyrtuar plotësimin e kushteve të tekfirit dhe mungesën e pengesave të tij.
- Kur njeriu nuk respekton fare parimet e rregullat që lidhen me domosdoshmëritë jetike, përmbushajn e synimeve të shariatit, realizimin e dobive dhe shmangien e dëmeve. E kam fjalën për rregullat që i kanë sqaruar fukahatë e ymetit dhe kanë sjellë argumente të qarta për to.

- Kur njeriu nuk e pranon që thirrja e jomuslimanëve, ose fillestarëve në Islam ose të paditurve në fe, bëhet në mënyrë të shkallëzuar, duke i renditur çështjet e fesë sipas rëndësisë dhe përparësisë, por edhe duke marrë parasyshë kapacitetin mendor të njerëzve për t'i kuptuar çështjet fetare në diskutim. Këtu e kam fjalën për ata që e kanë kthyer në metodë dhe parim mosrespektimin e këtyre rregullave, e jo për ata që mund të gabojnë në mënyrën e thirrjes nga padituria, nxitimi apo gabime të tjera që vijnë nga natyra njerëzore. Në fillimet e thirrjes Profeti ftonte në teuhid dhe besimin e Ditës së Gjykimit, përshkruante begatitë e Xhenetit dhe vuajtjet në Zjarrin e Xhehenemit, urdhëronte për faljen e namazit dhe dhënien e zekatit dhe këshillonte për moral të mirë. Më pas, kur njerëzit u rrënjosën në iman, zbritën dispozitat

e lejimit dhe ndalimit. Shih hadithin e Aishes në Sahihun e Buhariut (4994). Kur Profeti (a.s.) e dërgoi Muadhin në Jemen, e urdhëroi që gjëja e parë në të cilët do t'i ftonte njerëzit të ishte teuhidi. Nëse njerëzit do ta pranonin teuhidin, atëherë Muadhi do t'i ftonte të falnin pesë namazet. Shih hadithin e Abdullah Ibn Abasit në Sahihun e Buhariut (7372) dhe Sahihun e Muslimit (19). Një burrë shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe pranoi Islamin me kushtin që të falte vetëm dy namaze. I Dërguari i Allahu e pranoi me këtë kusht Shih Musnedin e Ahmedit (23079). Hadithi është i saktë. Kjo nuk do të thotë se ky burrë nuk i kishte detyrë pesë namazet apo se Profeti (a.s.) e rrëzoi detyrën e faljes së pesë namazeve për të, përkundrazi, Profeti (a.s.) e pranoi prej tij këtë kusht të pavlefshëm për ta nxitur atë të pranonte Islamin. Disa ligje zbritën gjatë viteve të fundit të jetës së

Muhamedit (a.s.), siç është përshembull ndalimi i kamatës.

- Përpyjekja për t'i bërë rivalitet politik KMSH-së në drejtimin e xhamive dhe shpalljen e muajit të ramazanit e bajramit, edhe pse drejtuesit e KMSH-së mund të kenë probleme fetare. Pra, nuk e kam qëllimin se vendimet e KMSH-së mbi mënyrën se si e caktojnë hyrjen dhe daljen e muajit hënorë janë të sakta, por nuk lejohet përçarja e muslimanëve në gjëra të mëdha si hyjra dhe dalja e muajit të agjërimit dhe festat e bajramit. Muslimanët duhet të fokusohen në përmirësimin dhe këshillimin për mirë të strukturave të KMSH-së, por jo në përçarjen e xhematit të muslimanëve në namaz, agjërim, dhe ditën e bajramit.

Muslimani duhet të ruhet nga të dyja drejtimet e këqija, si nga lehtësimi e këqija në fenë e Allahut e shtrembërimi i teksteve

apo mësimëve të Islamit për t'i plotësuar dëshirën vetes ose për t'u plotësuar dëshirat njerëzve, edhe nga mendimet ekstreme. Këto dy kahe janë me pasoja të rëndë në Dynja dhe në Ahiret. Për të paralajmëruar nga rezultatet e këqija të lehtësimeve të këqija (ideve liberale) mjafton të përmend ajetet e Kuranit: “Atëherë, ai që ka shkelur ligjet e Zotit dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote (plotësimin e dëshirave të këqija dhe kënaqësitë e përkohëshme kundrejt besimit, punëve dhe sjelljes së mirë që sjellin të mirat e Botës së Përtejme), sigurisht që do të ketë vendbanim, Zjarrin e Xhehenemit. Kurse ai, që i është frikësuar qëndrimit para Zotit të Tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat e këqija, pa dyshim që do të ketë vendbanim Xhenetin” [En-Naziat: 37-41]. Ndërsa si paralajmërim nga ekstremi dhe pasojat e tij po sjell dy thënie të Profetit: “Ruajuni teprimeve (el guluv), se vërtet ata që kanë



qenë para jush i shkatërroi vetëm teprimi” (Ahmedi). Sipas Albanit hadithi është i saktë. Thënia e dytë: “Të shkatërruar janë ekstremistët (el mutenatiune)”. Këtë Profeti (a.s.) e përsëriti tri herë (Muslimi).

Për të shpëtuar nga drejtimet e këqija muslimani duhet të ndjekë Kuranin dhe Sunetin e saktë në përputhje me mënyrës se si i kanë kuptuar të parët e këtij umeti. Pra, duhet të ecim në udhën e mesme të Profetit, sahabëve, dhe dijetarëve ndjekës të sunetit, pasues të selefrit, brez pas brezi, deri në kohën tonë. Dijetarë bashkëkohorë që ia vlen të merren si shembull për ndjekjen e rrugës së mesme të Profetit dhe sahabëve janë Albani, Ibn Bazi, Ibn Utnejmini dhe të tjerë dijetarë që janë në këtë udhë të drejtë e të mesme. Nga ana tjetër, mund të marrim mësim dhe nga përfundimi i keq i bidatçijve ndër shekuj, e sidomos në kohën tonë, dhe të ruhemi nga drejtimet e tyre.

Si përfundim, këtu në këtë material kam si qëllim që në këto çështje, nga njëra anë, të sqaroj rrugën e mesme të bazuar në Kuran dhe Sunetin e saktë në të cilën ka qenë Pejgamberi (a.s.) dhe selefii i këtij ymeti, dhe nga ana tjetër, të vë në dukje disa gabime që shfaqen në dy drejtimet e gabuara; atë me prirje liberale dhe atë me prirje ekstreme. Kështu, nuk është qëllimi të rrëzojmë figurën e ndonjë muslimani e aq më pak ta quajmë atë kafir. Gjithashtu, ky shkrim nuk ka si qëllim të prishë paqen me komunitetet e tjera fetare ose të nxisë intolerancë ndaj tyre.

***Vel hamdulilahi rabbil alemin.***

Shkruar nga *Ismail Bardhoshi*



## **Përmbajtja**

Tri Parimet e Besimit Islam .....	3
Parimi i parë .....	8
Parimi i dytë.....	16
Parimi i tretë .....	25
Fetvaja e Komisionit të përhershëm të fetvave mbi propagandën për unifikimin e feve.....	34
Studim.....	53
Disa qëndrime me tendencë liberale.....	81
Disa qëndrime me tendencë ekstreme...	92